



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1481 Prot.

Gjirokastrë, më 08/11/2019

V E N D I M

Nr. 23, datë 08.11.2019

**MIRATIMI I NGARKESËS MËSIMORE VJETORE TË PERSONELIT AKADEMIK NË
UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" PËR VITIN AKADEMIK 2019 – 2020.**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 59, pika 8 dhe udhëzimit nr. 29 datë 10.09.2018 të MASR-së "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës, 08.11.2019, :

V E N D O S I :

1. Të miratojë ngrarkesën vjetore të personelit akademik në universitetin "Eqrem Çabej", për vitin akademik 2019 – 2020, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Pagesa e orëve suplementare të kryhet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Një kopje e këtij vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim dhe zbatim !


REKTOR
Prof. dr. Bektash MEMA




REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1481 / Prot.

Gjirokastër, më 08 / 11 /2019

Lënda: Dërgohet vendimi nr.23, datë 08.11.2019 i Senatit Akademik.

BORDI I ADMINISTRIMIT
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
KËTU

Bashkangjitur po ju dërgojmë vendimin nr. 23, datë 08.11.2019 të Senatit Akademik për zbatim nga ana Juaj.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

REKTOR

Prof.dr.Bektash MEMA

